

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 29.6.2016 “Mbi miratimin e rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 19.7.2016, faqe 10485, në rregulloren bashkëlidhur vendimit:

Në nenin 14 “**Pranimi ose refuzimi për licencim i aplikuesit**”, pika 1

Ishte:

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit brenda 60 ditëve pune nga data e publikimit të parë të njoftimit për aplikimin në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Bëhet:

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike brenda 60 ditëve pune nga data e publikimit të parë të njoftimit për aplikimin në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.